



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0775

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE BAJRAM HA.GASHI B.I., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-25-2296-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal - Rahovec, më 24.10.2025 mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e BAJRAM HA.GASHI B.I., me nr. 2025/0775, e datës 13.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim”, me numër të prokurimit 623-25-2296-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Kuvendi Komunal - Rahovec.
2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Kuvendi Komunal - Rahovec për aktivitetin e prokurimit “Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim”, me numër të prokurimit 623-25-2296-5-2-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.03.2024 Kuvendi Komunal - Rahovec, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Rrethimi i oborreve të shkollave

– Ritenderim” me numër të prokurimit 623-25-2296-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 60,000.00 €.

Me 29.07.2025 BAJRAM HA.GASHI B.I., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), për aktivitetin e prokurimit ““Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-25-2296-5-2-1, ku ka anuluar këtë aktivitet.

Me 01.08.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 04.08.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.08.2025, OE BAJRAM HA.GASHI B.I., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0775, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues BAJRAM HA.GASHI B.I., janë parashtruar si në vijim:

Të nderuar, Kjo procedurë e prokurimit, kur është publikuar tani, kanë kaluar rreth 6 muaj dhe ende nuk ka marrë epilog si rezultat i prolongimit dhe shkeljeve ligjore të AK – Komuna Rahovec, zyrës së prokurimit, favorizimit ndaj OE të caktuar dhe gjegjësisht diskriminimit ndaj kompanisë sonë. Kundërligjshmëria e veprimeve të AK – Komuna Rahovec, si në vlerësimin fillestar ashtu edhe në proces të rivlerësimit, është konfirmuar edhe me vendim të OSHP-së të datës 21.07.2025 nr. OSHP: 2025/0390, ku AK – Komuna Rahovec është obliguar që lëndën ta kthejë në rivlerësim, përkatësisht oferta jonë ndaj arsyetimit të eliminimit në vlerësim paraprak është kualifikuar si e përgjegjshme. Provë: Vendimi i datës 21.07.2025 nr. OSHP: 2025/0390. Operatori Ekonomik ankues, Bajram Gashi BI, si palë në procedurë dhe me interes juridik, bazuar në afatet e parapara me LPP, ka deponuar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të fundit të AK-së të datës 29.07.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit, por çuditërisht AK – Komuna Rahovec me vendimin e datës 04.08.2025 refuzon kërkesën tonë si të pabazuar dhe lë në fuqi vendimin e saj për anulim të procedurës, prandaj sipas nenit 109 të LPP-së paraqesim faktet dhe dëshmitë për veprime kundërligjore.

Pretendimi ankimor 1. Pas urdhrit për rivlerësim nga OSHP dhe pavarësisht faktit se ne si OE jemi kualifikuar si të përgjegjshëm, ndaj pretendimeve ankimore AK – Komuna Rahovec me datën 29.07.2025 ka nxjerrë njoftim mbi vendimin e AK-së dhe pretendon ta anulojë aktivitetin e prokurimit, me arsyetim fiktiv dhe atë si më poshtë: "Tek deklarata e nevojave dhe përcaktimit të

disponueshmërisë së fondeve ka ndryshime. Me arsyetimin nga zyrtari Kryesor Financiar ka cekur: Mjetet financiare për këtë projekt janë paraparë të sigurohen nga kodi buxhetor 55185. Ju njoftojmë se kodi buxhetor për shkak se janë shpenzuar nga përmbaruesi – thesari, si pasojë e kontratës kolektive. Në mungesë të mjeteve buxhetore aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet."Ky arsyetim i anulimit paraqet shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së dhe ligjit mbi menaxhimin e financave publike, pasi që AK fillimisht obligohet që të ngarkojë disponueshmërinë e mjeteve e cila ekziston në platformën e-prokurimi, e nënshkruar dhe konfirmuar nga ZKF, ZKA dhe ZPP të Autoritetit Kontraktues në fjalë. Dispozitat e nenit 9, par. 5 të LPP-së përcaktojnë si vijon: 5. "Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1 deri 4 të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve". Deklarata e tillë e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve do të përmbajë informatat në vijim: (i) një deklaratë të nevojave me shkrim, e cila i përmbledh rezultatet e vlerësimit të nevojave që është bërë nga autoriteti kontraktues sipas paragrafit 1 të këtij neni, (ii) një deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve, që demonstroi se autoriteti kontraktues i ka përmbushur obligimet e tij sipas paragrafit 2 të këtij neni, (iii) nëse është e aplikueshme, atëherë duhet që gjithashtu të dorëzohet një deklaratë me shkrim që i parashtron bazat, që kërkohen nga paragrafi 3 i këtij neni."

Prandaj, në këtë fazë AK në asnjë rrethanë nuk mund ta ndërpres, përkatësisht ta anulojë procedurën në fjalë të prokurimit. Bazuar në pikën K) të nenit 97 të Rregullores për Prokurim Publik, me nr. 001/2022, mosrespektimi i vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit konsiderohet si shkelje e rëndë e Ligjit për Prokurim Publik. Si shkelje e tillë konsiderohet edhe tentativa për anulim të procedurës së prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së (shih pikën H të nenit 97 të RPP-së, nr. 001/2022). Për kësë çështjesh, gjegjësisht për anulim të procedurës së prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së – KRPP, ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka ndërmarrë veprime ligjore dhe ka revokuar certifikatën e prokurimit pas kërkesës së OSHP-së, si referencë lidhur me këtë shërben vendimi me nr. 67/2022 i datës 30.12.2022.

Konfirmimi për veprime kundërligjore të AK – Komuna Rahovec ndaj kësaj procedure të prokurimit, ndaj tentativës për anulim të kundërligjshëm dhe fiktiv të procedurës, tregohet me faktin se procedura e prokurimit është e planifikuar dhe është publike në platformën e-prokurimi, si rrjedhojë anulimi i aktivitetit se nuk ka mjete buxhetore tregon për shkelje të parimeve dhe dështim në lidhje të kontratës me kompani të parapërcaktuar.

Pretendimi ankimor 2. Përveç asaj që u përshkrua më lartë, AK me njoftimin mbi vendimin e datës 29.07.2025 ka konsumuar edhe shkelje të nenit 42 të Rregullores me nr. 001/2022 për Prokurim Publik, paragrafi 1 dhe 3 përcaktojnë: 42.1 Të gjithë tenderuesit/kandidatët duhet të informohen nga AK përmes publikimit të Formularit B58 "Njoftimit mbi Vendimin e AK". 42.3 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për tenderuesit me arsyetimet e nevojshme. Në si OE, në procesin e rivlerësimit të ofertave, nuk kemi pranuar letër standarde pavarësisht faktit se jemi pjesë e procedurës dhe jemi palë me interes juridik bazuar në nenin 4.1.26 të LPP-së. Nxjerrja e letrës standarde është e obligueshme për secilin Autoritet Kontraktues përkatës. Me Ligjin për Prokurim Publik, parimi i konsistencës, i paanshmërisë, gjegjësisht mos-trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomik, pavarësisht procedurave të prokurimit, mosrespektimi i vendimit të OSHP-së dhe anulimi i aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së konsiderohen si shkelje të rënda të Ligjit për Prokurim Publik. Neni 97 i Rregullores me nr.

001/2022 për PP, par. 1, pika d), h) dhe k), përcaktojnë: 97.1 Shkelje të rënda konsiderohen: k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Me 24.03.2025 Komuna e Rahovecit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim, me numër të prokurimit: 623-25-2296-5-2-1, numër i brendshëm: 623-25-019-5-2-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës punë, me vlerë të parashikuar të kontratës: 60,000.00 Euro. Me 08.05.2025, AK: Komuna e Rahovecit ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin, ku ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik: AGE Group SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Me 13.05.2025 Operatori Ekonomik: Bajram H. Gashi B.I., ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim. Me 14.05.2025 Autoriteti Kontraktues me Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës e ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga Operatori Ekonomik.

Me 22.05.2025, Operatori Ekonomik: Bajram H. Gashi B.I., ka parashtruar Ankesë në OSHP me numër protokolli 2025/0390 lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim, me numër të prokurimit: 623-25-2296-5-2-1, numër i brendshëm: 623-25-019-5-2-1. Me 09.06.2025, AK: Komuna e Rahovecit ka pranuar Raportin e Ekspertit Shqyrtues të OSHP-së, numër i lëndës: 2025/0390 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Me 21.07.2025, AK: Komuna e Rahovecit ka pranuar Vendimin e OSHP-së: 2025/0390 lidhur me aktivitetin e prokurimit, ku në pikën 2 të vendimit thuhet: Anulohet B58 Njoftim mbi Vendimin e AK të Kuvendit Komunal – Rahovec, ndërkaq aktiviteti i prokurimit: Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim, me numër të prokurimit: 623-25-2296-5-2-1 kthehet në rivlerësim. Po ashtu në pikën 3 të vendimit thuhet: “Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mosrespektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.”

Me 23.07.2025, AK: Komuna e Rahovecit e ka njoftuar OSHP-në në bazë të Vendimit: 2025/0390 lidhur me aktivitetin e prokurimit, duke cekur: Ne si Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, e kemi respektuar të gjitha pikat e këtij vendimi. Në attachment gjeni të bashkëngjitur Vendim – Për caktimin e Komisionit për Rivlerësimin e ofertave – Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim. Komisioni rivlerësues do të bëjë rivlerësimin e ofertave në afatet kohore në bazë të LPP-së.

Arsyetim- Sipas Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në nenin 67.7 ceket: Një vendim i OSHP-së për rivlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit, edhe para përgatitjes së B58 – Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues si dhe letrat standarde për OE, ne si Zyrë e Prokurimit kemi kërkuar nga ZKF-ja dhe ZKA-ja të bëjnë shqyrtimin e Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, ku në nenin 3 të kësaj Deklarate kërkohet: “Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve” duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim të kontratave para publikimit të B58 “Njoftimit mbi vendimin e AK-së”, me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht.

Me arsyetim nga Zyrtari Kryesor Financiar, ka cekur: Mjetet financiare për këtë projekt janë paraparë të sigurohen nga kodi buxhetor: 55185. Ju njoftojmë se në këtë kod buxhetor nuk ka mjete buxhetore për shkak se janë shpenzuar nga përmbaruesi/thesari, si pasojë e kontratës kolektive, duke e bashkëngjitur Raportin nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK), ku ju kemi informuar duke cekur: Referohuni Deklaratës së Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve dhe Raportit të Analizave të Llogarive nga Thesari, të bashkëngjitur në sistemin e e-prokurimit si dokument shtojcë.

Në bazë të fakteve dhe rrethanave procedurale, ankesa në OSHP është dorëzuar me datë: 22.05.2025, ndërsa me datë: 21.07.2025 është pranuar vendim nga OSHP-ja: 2025/0390. Mjetet e parapara me buxhet për këtë aktivitet të prokurimit janë nga kodi buxhetor: 55185, ku janë tërhequr nga Thesari sipas vendimit gjyqësor me datë: 02.06.2025 (shih raportin nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK). Për çështje të njëjta ka edhe vendim nga OSHP, si p.sh. vendimi OSHP: 2025/0386.

Nga konstatimet e lartcekura u vendos si në dispozitivat e këtij vendimi. Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.08.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0775, ndërsa me datë 25.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0775, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi anulimin e autoritetit kontraktues të datës 29.07.2025.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE BAJRAM HA.GASHI B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0775 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar e kontratës është: 60,000.00 €. Ndërsa, kriteri i dhënies së kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm”. Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të Nënkriteret Koeficient 1 Çmimi 0.70, 2 Afati me i gjatë i Periudhës Garantuese deri në max. 24, Muaj 0.3.

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit anulimit të aktivitetit të prokurimit, kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa ekspertja

shqyrtuese ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.0390/2025, të datës 09.06.2025. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.0390/2025, të datës 21.07.2025, duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e OE “Bajram Ha.Gashi” B.I –Suhareke, kurse ka anuluar njoftimin mbi vendimin e AK-së B58, dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 10, 24, 25, 52, 56, 59 62, 69 dhe 108/A të LPP-së, si dhe shkelje të dispozitave të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht të nenit 38, 40, 43 dhe 97 të Rregullores. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se edhe pas rivlerësimit nga OSHP dhe pavarësisht faktit se ne si OE jemi kualifikuar si të përgjegjshëm ndaj pretendimeve ankimore AK Komuna e Rahovecit, me datën 29.07.2025, ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe pretendon ta anulojë aktivitetin e prokurimit me arsyetimin: “Tek deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve ka ndryshime. Me arsyetimin nga zyrtari Kryesor Financiar ka cekur: Mjetet financiare për këtë projekt janë paraparë të sigurohen nga kodi buxhetor 55185. Ju njoftojmë se kodi buxhetor për shkak shpenzimeve nga përmbaruesi –thesari si pasojë e kontratës kolektive. Ne mungesë të mjetëve buxhetore aktivitetit i prokurimit duhet të anulohet”

Tutje OE ankues potencon se ky arsyetim i anulimit paraqet shkelje të dispozitave të LPP-së, dhe ligjit mbi menaxhimin e financave publike, pasi që AK fillimisht obligohet që të ngarkojë disponueshmërinë e mjeteve e cila ekziston në platformën e-prokurimit e konfirmuar nga ZKF, ZKA dhe ZPP të Autoritetit Kontraktues. Ky veprim bie ndesh me nenin 9.5 të LPP-së, pasi në këtë fazë AK në asnjë rrethanë nuk mund ta anulojë aktivitetin e prokurimit, po ashtu edhe nenin 97 pika k) të Rregullores për Prokurim Publik mosrespektimi i vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit konsiderohet si shkelje e rend.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron se ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, Paneli Shqyrtues me Vendimin PSH.nr.0390/2025, të datës 21.07.2025, ka aprovuar pjesërisht ankesën e OE “Bajram Ha.Gashi” B.I –Suhareke, kurse ka anuluar njoftimin mbi vendimin e AK-së B58, dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim. Gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues duke u bazuar në mungesën e mjeteve financiare në kodin buxhetor 55185, konkretisht me arsyetimin si në vijim:

“Tek deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve ne Nenin 3: Shqyrtim: Kjo “Deklaratë e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve” duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim të kontratave para publikimit të B58” Njoftimit mbi vendimin e AK-së” me qellim që të ri konfirmohet se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht.

Ndryshimet: Me arsyetimin nga Zyrtari Kryesor Financiar ka cekur: Mjetet financiare për këtë projekt janë paraparë të sigurohen nga kodi buxhetor: 55185. Ju njoftojmë se në këtë kod buxhetor nuk ka mjete buxhetore për shkak se janë shpenzuar nga përmbaruesi –thesari si pasojë e kontratës kolektive. Ne mungesë të metëve buxhetore aktivitetit i prokurimit duhet të anulohet”. Referoju Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve dhe Raporti i analizave të llogarive nga Thesari të bashkangjitur në sistemin e-prokurimit si dokument shtojë” thuhet në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar me

datë 29.07.2025.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se sipas raportit të analizave të llogarive, e shkarkuar nga SIMFK është evidente se mjetet nga ky kod buxhetor (55185) janë tërhequr me datën: 02.06.2025, nga zyra përmbartimore me përshkrimin Vendim Gjyqësor. Pra, duke qenë se mjetet nuk janë më në dispozicion dhe kjo është e konfirmuar me dokumentacion zyrtar, anulimi i aktivitetit në këtë fazë është i justifikuar dhe gjen mbështetje në nenin 8 (Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve), pika 8.5 e Rregullores, ku kjo dispozitë i obligon personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDP që para publikimit të Formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDP) nuk kanë ndryshuar. Në rastin konkret, pas rikonfirmimit informatat financiare kanë ndryshuar, ka rezultuar me mungesë të fondeve për shkak të ekzekutimit nga përmbartuesi sipas vendimit të Gjykatës. Andaj, nëse AK do të hynte në marrëdhënie kontraktuale pa pasur fonde për këtë kontratë, atëherë do të qonte në shkelje të nenit 8, pika 8.5 e Rregullores për Prokurimit Publik. Andaj, konsideroj se AK ka zbatuar drejt dispozitat ligjore në lidhje me anulimin e kësaj procedure për shkak se neni 43.5, pika “i” e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, parasheh: i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; Sa i përket pretendimi të OE ankues, konsideroj se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar por nuk mund të ndodhë ndonjë ndryshim pa mjete për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se AK ka bere shkelje të nenit 42 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik pasi paragrafi 1 dhe 3 përcaktojnë: 42.1 Të gjithë tenderuesit/kandidatët, duhet të informohen nga AK, përmes publikimit të Formularit B58 “Njoftimit mbi Vendimin e AK”, 42.2 Në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, tenderuesit/kandidatët dhe çdo palë e interesuar duhet të informohen nga AK përmes publikimit të Formularit B58 – “Njoftimit mbi Vendimin e AK” dhe Njoftimit për dhënie të kontratës (B08) njëkohësisht, dhe nga i cili publikim fillojnë afatet kohore për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave. 42.3 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme. OE ankues potencon se në procesin e rivlerësimit të ofertave nuk kemi pranuar letrën standarde pavarësisht faktit se jemi pjesë e procedurës dhe jemi palë me interes juridik bazuar në nenin 4.1.26 të LPP-së, nxjerrja e letrës standarde është obligueshme për secilin autoritet kontraktues.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se meqenëse aktivitetit ka qenë në fazën e rivlerësimit dhe tashmë është anuluar, AK konsideroj se ka njoftuar operatorët ekonomik me letrë standarde mbi rezultatet pasi rezultati final është anulimi i aktivitetit. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Komuna e Rahovecit, të mbajë në fuqi njoftimin për anulim të datës 29.07.2025, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se

pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal - Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-25-2296-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - BAJRAM HA.GASHI B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: